



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranim / Dorezuar Prijeto / Predato Received / Delivered	03.06.2022	2	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKM/SHCK	3253/2022		1/5



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.342/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë, me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, për shqyrtimin e ankesës me numër A.nr.342/2022 të datës 07.04.2022 me numër protokolli 1939/2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë Rruga kundër Njoftimit të Departamentit të Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 03.06.2022, mori këtë.

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.342/2022 e parashtruar me datë 07.04.2022 nga ankuesi

II. MBETET në fuqi Njoftimi i Departamentit të Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kosovare të Privatizimit i datës 31.03.2022.

A r s y e t i m

Ankuesi sipas Akt Emërimit me referencë: 213/DKL1 të datës 05.08.2014 i punësuar në Agjencinë Kosovare të Privatizimit në pozitën "Drejtor i Departamentit të Likuidimit" me datë 07.04.2022 ka parashtruar ankesë me numër të protokolli 1939/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor me të cilin e konteston njoftimin e Komisionit për Vlerësim dhe Pranim nga Departamenti i Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës së Përgjithshme Administrative, shkeljes thelbësore të dispozitave të Ligjit për Zyrtarët

Publik dhe shkeljes së Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e funksionit Publik.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës, më datë 21.04.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, ndërsa kjo e fundit me datë 04.05.2022 ka përcjell përgjigjen në ankesë me numër protokolli 2578/2022 së bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë dhe nevojës për shqyrtime shtesë dhe sqarime të mëtejme të pretendimeve ankimore të ankuesit dhe për shkak të volumit të lëndës dhe kompleksitetit të saj, sipas kërkesës së Kryetarit të Kolegjit, Kryetari i Këshillit me datë 18.05.2022 ka nxjerre vendimin me numër:46/2022 për shtyrjen e afatit të vendosjes edhe për dhjetë (10) ditë-ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova: Ankesën me Nr. protokolli 1939/2022 të datës 07.04.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftim i datës 31.03.2022; E-mail nga [simbnj@rks-gov.net](mailto:simbunj@rks-gov.net) për M.A. i datës 31.03.2022; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 21.04.2022; Përgjigje në ankesë e datës 04.05.2022; Vendim me nr. Ref. BD-155/3 i datës 06.12.2021; Konkurs me nr. reference RN00007978 i datës 15.12.2021; Vendim i datës 14.02.2022; Lista e aplikantëve simbnj; Lista e aplikantëve simbnj; Njoftim i datës 03.02.2022; Njoftim i datës 09.02.2022; Aplikacioni i M.A. i datës 27.01.2022; Certifikatë e M.A. e datës 12.01.2022; Letërnjoftim i M.A.; Licencë e M.A. me nr.1/2021 e datës 07.06.2021; Diplomë e M.A. me nr. 28/10 i datës 16.11.2010; Diplomë e M.A. me nr. 57 i datës 12.12.2007; Letër motivuese e M.A.; Referencë e datës 07.10.2005; Referencë e datës 12.06.2008; Vërtetim mbi përvojën e punës për M.A. i datës 18.01.2022; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional për M.A. i datës 23.02.2021; Plani individual i trajnimit i datës 23.02.2021; Formulari për përcaktimin e objektivave të punës për M.A. i datës 23.02.2021; Formulari për përcaktimin e objektivave të punës për M.A. i datës 24.01.2022; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional për M.A. i datës 24.01.2022; Plani individual i trajnimit i datës 24.01.2022; Aplikacioni i B.S. i datës 27.01.2022; Akt Emërim i B.S. i datës 01.10.2021; Akt Emërim i B.S. i datës 03.12.2013; CV-ja e B.S. Diplomë e B.S. me nr. 3005 i datës 23.03.2017; Diplomë e B.S. me nr. protokolli 192/541-978/33 i datës 09.10.1999; Diplomë e B.S. me nr. 04/2017 i datës 21.04.2017; Certifikatë e B.S. i datës 27.10.2021; Kontratë e Marrëdhënies së Punës e B.S. i datës 06.03.2006; Kontratë për punësim në kohë të caktuar e B.S. e datës 28.06.2004; Vendim me nr. protokolli 13/2021 i datës 05.10.2021; Vendim me nr. protokolli 09/2016 i datës 22.04.2016; Vendim me nr. protokolli 162/2016 i datës 30.08.2013; Vendim me nr. protokolli 04/2013 i datës 03.01.2013; Vendim për autorizim me nr 01-13 i datës 18.07.2012; Vendim me nr. 18/2011 i datës 01.08.2011; Kërkesë me nr.08/2011 e datës 06.07.2011; Marrëveshje e datës 28.07.2011; Kontratë e Marrëdhënies së punës e B.S. e datës 30.04.2011; Vendim me nr. protokolli 1201/2009 i datës 05.05.2009; Raport me nr. protokolli 1210/09 i datës 17.06.2009; Letërnjoftim i B.S.; Pasaporta e B.S.; Letër motivimi i B.S. i datës 27.01.2021; Letër rekomandimi për B.S. i datës 01.04.2009; Letër rekomandim për B.S. i datës 05.11.2021; Letër falënderimi për B.S. i datës 16.05.2006; Mirënjohje për B.S. i datës 29.12.2006; Mirënjohje për B.S. i datës 31.12.2007; Vendim për B.S. i datës 11.01.2007; Vendim për themelimin e komitetit të auditimit të brendshëm i datës 27.08.2008; Vendim për B.S. i datës 26.08.2008; Certifikatë e B.S. i datës 15.10.2006; Certifikatë e B.S. i

datës 30.04.2006; Certifikatë e B.S. i datës 22.09.2013; Certifikatë e B.S. i datës 14.04.2013; Certifikatë e B.S. i datës 25.10.2009; Certifikatë e B.S. i datës 27.08.2012; Certifikatë e B.S. i datës 29.04.2016; Certifikatë e B.S. i datës 01.04.2015; Certifikatë e B.S. iso 27001; Certifikatë e B.S. i datës 25.06.2015; Certifikatë e B.S. i datës 18.03.2009; Certifikatë e B.S. i datës 18.05.2012; Certifikatë e B.S. i datës 17.07.2016; Certifikatë e B.S. i datës 31.07.2016; Certifikatë e B.S. i datës 07.05.2000; Certifikatë e B.S. i datës 05.12.2009; Certifikatë e B.S. i datës 12.12.2008; Certifikatë e B.S. i datës 27.06.2008; Vërtetim mbi përvojën e punës së nëpunësit B.S. i datës 29.10.2021; Vlerësimi për vitin 2020; Vendim me nr.01-52 i datës 16.06.2021; Formulari për përcaktimin e objektivave të punës për M.A. i datës 24.01.2022; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional për B.S. i datës 25.01.2022; Aplikacioni i A.L. i datës 27.01.2022; Vërtetim mbi punësimin i A.L. i datës 26.01.2022; Certifikatë e A.L. i datës 21.01.2022; Certifikatë e A.L. i datës 02.11.2019; Certifikatë e A.L. i datës 13.06.2014; Certifikatë e A.L. i datës 31.05.2008; Certifikatë e A.L. i datës 14.04.2011; Vendim me nr.216/378 i datës 11.05.2021; Certifikatë e A.L. i datës 22.05.2019; Diplomë me nr.1550 i datës 18.09.2007; Kontratë pune e A.L. i datës 01.12.2017; Kontrata e punës e A.L. e datës 01.01.2009; Aneks i kontratës së punës i A.L. i datës 22.04.2009; Kontrata e punës e A.L. e datës 11.12.2009; Kontrata e punës e A.L. e datës 11.01.2010; Kontratë e punësimit e A.L. i datës 27.09.2011; Kontrata e punës e A.L. e datës 28.12.2011; Kontrata e punës e A.L. e datës 21.07.2017; Kontrata e punës e A.L. e datës 28.09.2020; Letër motivuese e A.L.; Letërnjoftim i A.L.; Referencë e datës 03.01.2009; Letër rekomandim për A.L. i datës 23.01.2007; Shkresë e datës 26.01.2022; Letër rekomandim për A.L. i datës 16.12.2008; Formulari për vlerësimin e detyrave në punë për A.L. i datës 29.01.2021; Formulari për përcaktimin e objektivave të punës i A.L. i datës 29.01.2021; Plani individual i trajnimit i datës 29.01.2021; Formulari për vlerësimin e detyrave në punë i A.L. i datës 21.01.2020; Formulari për përcaktimin e objektivave të punës i A.L. i datës 21.01.2020; Plani individual i trajnimit i datës 21.01.2020; Njoftim i datës 23.02.2022; Pyetjet e hapura për testin individual simbnj kandidati CN0310; Pyetjet e hapura për testin individual simbnj kandidati CN0530; Pyetjet e hapura për testin individual simbnj kandidati CN7735; Pasqyra e përgjithshme e poentimit të Eseve i datës 31.03.2022; Pasqyra e përgjithshme e poentimit të Eseve i datës 31.03.2022; Pasqyra e përgjithshme e poentimit të Eseve i datës 31.03.2022; Pasqyra e përgjithshme e poentimit të Eseve i datës 31.03.2022; Renditja përfundimtare e kandidatëve i datës 31.03.2022; Ekstrakt nga sistemi elektronik HRMIS; E-mail nga L.XH.T. për M.A. i datës 31.03.2022; Njoftim i datës 31.03.2022; Lista e kandidatëve fitues i datës 01.04.2022; Raporti përfundimtar i Komisionit të Pranimit për procesin e rekrutimit për pozitën Drejtor Menaxhues i AKP-së i datës 08.04.2022; Vendim me nr.Ref. BD-161/1 i datës 14.04.2022; Akt Emërimi i M.A. i datës 05.08.2014; Përshkrimi i Detyrave të Punës; Aneks Akt i Emërimit i M.A. i datës 02.03.2018; Përshkrimi i Punës; Vendimin me numër:46/2022 të Kryetarit të Këshillit i datës 18.05.2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar që ankesa e ankuesit *është e pabazuar sepse:*

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, mbi bazën e shkresave të lëndës ka konstatuar se Agjencia Kosovare e Privatizimit me datë 15.12.2021 ka shpallur konkursin për pozitën "Drejtor Menaxhues i AKP-së" me kërkesat e përgjithshme formale:

Diplomë/a të studimeve universitare me të paktën 240 kredi/ECTS apo ekuivalente me to; Kualifikime të posaçme formale dhe përvojë e punës: së paku tetë (8) vite përvojë pune profesionale, duke përfshirë së paku pesë (5) vite përvojë punë në pozita drejtuese.



Po ashtu, Kolegji ka konstatuar se në këtë pozitë ka aplikuar edhe ankuesi, ndërsa pas Njoftimi i Departamentit të Burimeve Njerëzore të Agjencisë Kosovare të Privatizimit i datës 31.03.2022 është konstatuar se i njëjti pas vlerësimit me pikët e përmbledhura nga testi me shkrim, jetëshkrimi dhe intervista me gojë nga ana e Komisionit të Pranimit është vlerësuar me gjithsejtë 68.83 pikë sipas njoftimit të datës 31.03.2022 dhe mbi këtë bazë nuk e ka plotësuar kriterin e nevojshëm për tu vlerësuar si kandidatë në mesin e kandidatëve të suksesshëm.

Kolegji po ashtu në bazë të shkresave të lëndës respektivisht përgjigjes në ankesë të Njesisë së Burimeve Njerëzore të AKP-së si dhe regjistrin të dhënave në Këshill, ka konstatuar se për të njëjtën procedurë të rekrutimit për pozitën "Drejtor Ekzekutivi i AKP-së" janë parashtruar edhe dy (2) ankesa të tjera në Këshill, ndërsa njëra prej tyre e evidentuar me numër A.nr.137/2022 të datës 16.02.2022 e ankuesit i cili e kishte kontestuar mos përfshirjen në listën e shkurt si dhe themelimin e Komisionit të Pranimit janë pretendime të cilat janë rrëzuar përmes vendimit të Këshillit me Numër A.nr.137/2022 i datës 15.03.2022, andaj mbi këtë bazë Kolegji konstaton se ndërlidhur me procedurën e rekrutimit për pozitën e lartcekur Kolegji ka vlerësuar se procedura e rekrutimit deri në fazën e zhvillimit të testit me shkrim është vlerësuar dhe shqyrtuar paraprakisht përmes vendimit të lartcekur të Këshillit dhe mbi këtë bazë pretendimet ankimore të ankuesit se vendimi për shpalljen e konkursit dhe formimin e komisionit të pranimit nuk janë formuar në pajtueshmëri me dispozitat e ligjit material, janë të paqëndrueshme pasi që Kolegji thekson faktin se Vendimi i datës 14.02.2022 i nxjerrë nga Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve për Formimin e Komisionit ad hoc i Pranimit për pozitën e lartë drejtuese është nxjerrë në pajtim me nenin 41 paragrafi 5 i Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, ku përcaktohet se "5. Komisioni i pranimit për pozita të kategorisë së lartë drejtuese, që themelohet në çdo institucion tjetër shtetëror, është ad hoc. Ai themelohet nga titullari i institucionit dhe përbëhet nga: 5.1. një përfaqësues i Njesisë përgjegjëse të institucionit; 5.2. dy nëpunës civilë të kategorisë së lartë drejtuese nga institucioni apo nga një institucion tjetër i Shërbimit Civil me përgatitje të veçantë në procesin e përzgjedhjes; 5.3. dy ekspert të jashtëm në procesin e përzgjedhjes nga organizata të specializuara" dhe nenin 10 të Rregullores Nr.15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues, respektivisht pretendimi ankimor i ankuesit lidhur me vendimin për shpalljen e konkursit është i paqëndrueshëm, sepse Bordi i Drejtorëve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit me vendimin e datës 06.12.2021 ka iniciuar procedurën e rekrutimit për pozitën Drejtor Menaxhues në AKP përmes konkursit publik.

Kolegji me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit ka analizuar dispozitat e Rregullores Nr.15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues neni 13 paragrafi 6 ku përcaktohet se: "Jo më shumë se tre (3) kandidatë dhe jo më pak se dy (2) kandidatë të vlerësuar nga komisioni i pranimit, me pikët më të larta dhe mbi pragun minimal të 70 e më shumë për qind të pikëve të përgjithshme të vlerësimit, konsiderohen kandidatë fitues dhe propozohen për përzgjedhjen përfundimtare nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë" dhe ka konstatuar se Njoftimi i datës 31.03.2022 i Departamentit të Burimeve Njerëzore të AKP-së, është i bazuar në dispozitat e lartcekura të rregullores, pasi që ankuesi nga vlerësimi i përgjithshëm i pikëve, nuk ka arritur të sigurojë pikët e nevojshme që kërkohen me qëllim që i njëjti të konsiderohet si kandidat i suksesshëm e më pas të propozohen në listë të përbashkët për përzgjedhje përfundimtare, ndërsa pretendimi ankimor i ankuesit se përzgjedhja e kandidatit është përcjelle me shkelje flagrante të procedurave është i paqëndrueshëm, ngase fillimisht përgatitet lista me kandidatët e suksesshëm të cilët arrijnë të grumbullojnë së paku 70 pikët e nevojshme e më pas lista me kandidatët e suksesshëm dërgohet për përzgjedhje, veprim procedural i cili deri në këtë fazë nuk është konsumuar respektivisht nuk ka



kandidatë të përzgjedhur, ndërsa lista me kandidatët e suksesshëm është përgatitur sipas Njoftimit të Departamentit Të burimeve Njerëzore të AKP-së i datës 01.04.2022.

Po ashtu, Kolegji në bazë të shkresave të lëndës ka konstatuar se ankuesi në testin me shkrim ka arritur të grumbulloi 17.05 pikë, respektivisht nga dy (2) pyetjet e parashtruara në formë eseje ka arritur të përgjigjet në vetëm njërin prej tyre (në pyetjen 2), dhe po ashtu në vlerësimin për jetëshkrimin-biografinë është vlerësuar me 12.38 pikë, ndërsa në intervistë me gojë ka rritur të vlerësohet me 39.4 pikë, andaj në kuptim të nenit 13 paragrafi 3 të Rregullores Nr.15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues, Kolegji thekson faktin se Komisioni i Pranimit ka vepruar në pajtueshmëri me dispozitat e aplikuara të rregullores në fjalë dhe se nuk ka vërejtur ndonjë lëshim i cili do të mund ta dëmtonte ankuesin në këtë proces, respektivisht pretendimet ankimore të ankuesit janë të pabazuara pasi që njoftimi i datës 31.03.2022 është bërë në pajtueshmëri me nenin 13 paragrafi 9 të Rregullores Nr.15/2020 për Pranimin, Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues ku përcaktohet se: *“Kandidatët që nuk janë fitues njoftohen personalisht dhe kanë të drejtën e ankimit në KPMSHCK, në afat kohor 8 dite kalendarike”*

Andaj, bazuar në konstatimin si me lartë dhe duke marr parasysh se veprimet procedurale lidhur me konkursin e shpallur me datë 14.01.2022 me nr. reference RN00007978, Kolegji ka konstatuar se konkursi i kontestuar në këtë procedurë deri në fazën e përgatitje së listës me kandidatit e suksesshëm për përzgjedhje përfundimtare, është zhvilluar në pajtim dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë si dhe dispozitat e Rregullores Nr.15/2020 për Pranimin Vlerësimin dhe Disiplinën e Nëpunësve të Lartë Drejtues.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila mendon se vendimi Këshillit nuk është i ligjshëm, mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës
Lënda me numër A.nr.342/2022.

Çlirim ZEKA

Çlirim
Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit Menaxhues të Agjencisë Kosovare të Privatizimit;
- Udhëheqësit të Personelit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit;
- Arkivit të KPMSHCK-së.